MARRËVESHJE

NDËRMJET

QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE
QEVERISË SË SHTETIT TË IZRAELIT

PËR

PËRJASHTIMIN E KËRKESËS PËR VIZA PËR MBAJTËSIT E

PASAPORTAVE DIPLOMATIKE DHE ZYRTARE

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Shtetit të Izraelit (çdoherë të referohet si në vijim "Palët");

Duke dëshiruar të përmirësojnë dhe zhvillojnë më tej marrëdhëniet miqësore që tashmë ekzistojnë midis dy shteteve;

Duke dëshiruar të lehtësojnë procedurat e udhëtimit për mbajtësit e pasaportave diplomatike dhe zyrtare të dy shteteve;

Kanë arritur marrëveshjen e mëposhtme:

Neni 1

Shtetasit e secilit shtet, të cilët janë mbajtës të pasaportave diplomatike dhe zyrtare të vlefshme, do të jenë të përjashtuar nga obligimi për të marrë një vizë për hyrjen në territorin e shtetit tjetër për një vizitë ose qëndrim që nuk kalon nëntëdhjetë (90) ditë nga data e hyrjes.

Neni 2

Shtetasit e secilit shtet, mbajtës të pasaportave diplomatike dhe zyrtare të vlefshme, që kanë qëllim të qëndrojnë në territorin e shtetit tjetër për një periudhë që tejkalon nëntëdhjetë (90) ditë, duhet të marrin një vizë paraprakisht.

Neni 3

Shtetasit e secilit shtet, mbajtës të pasaportave diplomatike të vlefshme, që ushtrojnë funksione zyrtare në shtetin tjetër si anëtarë të personelit diplomatik ose konsullor, të cilët qëndrojnë në territorin e shtetit tjetër së bashku me anëtarët e familjes së tyre, janë të detyruar të marrin një vizë tridhjetë (30) ditë pas datës së hyrjes. Vizat siç u përmend në këtë Nen do të jenë të vlefshme gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës së tyre.

Neni 4

Autoriteti kompetent i çdo Pale do të rezervojë të drejtën për të refuzuar hyrjen, për të ndërprerë ose për të shkurtuar periudhën e qëndrimit të çdo shtetasi të vendit tjetër që referohet në këtë Marrëveshje, midis të tjerash, në bazë të sigurisë kombëtare, rendit publik ose shëndetit publik.

Neni 5

Shtetasit e secilit shtet që hyjnë në territorin e shtetit tjetër në përputhje me këtë Marrëveshje, duhet që derisa janë në territorin e shtetit tjetër, të respektojnë ligjet dhe rregullat e shtetit të qëndrimit të tyre.

Neni 6

Marrëveshja mund të ndryshohet me miratimin e shkruar të të dyja Palëve. Ndryshimi i tillë do të jetë i vlefshëm sipas procedurave të përmendura në Nenin 9 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

Çdo mosmarrëveshje e lindur midis Palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje duhet të zgjidhet përmes konsultimeve dhe negociatave.

Neni 8

1. Palët do të shkëmbejnë mostra të pasaportave diplomatike të tyre të vlefshme nëpërmjet kanaleve diplomatike brenda tridhjetë (30) ditëve pasi të dy Palët nënshkruajnë këtë marrëveshje.

2. Kur një Palë lëshon një model të ri të pasaportave diplomatike ose modifikon ato të shkëmbyera tashmë, Pala tjetër do të njoftohet për këto modifikime nëpërmjet kanaleve diplomatike të paktën tridhjetë (30) ditë para datës së hyrjes në fuqi të pasaportave të reja ose modifikimeve. Njoftimi do të përfshijë një shembull të dokumenteve të reja ose të modifikuara dhe informacion mbi zbatueshmërinë e tyre.

Neni 9

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi për një periudhë fillestare të një (1) viti, në të tridhjetën (30) ditë të pranimit të njoftimit të dytë të notës diplomatike, përmes së cilës Palët njoftojnë njëra-tjetrën se kërkesat ligjore të brendshme për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes janë përmbushur. Kjo Marrëveshje do të zgjatet automatikisht për periudha të tjera të një (1) viti për çdo periudhë të re.
2. Marrëveshja do të mbetet në fuqi derisa njëra Palë njofton Palën tjetër me një shënim diplomatik për qëllimin e tij për ta shfuqizuar, të paktën nëntëdhjetë (90) ditë para datës së qëllimit të tij për të shfuqizuar Marrëveshjen.

Bërë në..... më ..... dita e ..... 2024, që përkon me ditën _____ të _____ 5784, në Kalendarin Hebraik, në tre tekste origjinale, në gjuhën Shqipe, Hebraike dhe Angleze, të gjitha tekstet janë në të njëjta dhe autentike. Në rast të ndryshimeve në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të mbizotërojë.

Për Qeverinë e
Republikës së Kosovës

Për Qeverinë e
Shtetit të Izraelit